



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net, tel. 0280390112

RAPORT I KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK PËR ANGAZHIM NË SEMESTRIN DIMËROR DHE VEROR VITI AKADEMIK 2020/21

Programi Master E-Qeverisje

Pozita e kërkuar sipas konkursit – Asistentët në lëndët e fushave të ndryshme, për semestrin dimëror dhe veror:

1. Parimet e Sistemeve Informative; Arkivimi Dixhital dhe Sistemet e Informimit; Informatike Sociale; Menaxhimi I Sistemit te informacionit; Programimi dhe E-Qeverisja.
2. Sistemet Virtuale; Programet Aplikative ne E-Qeverisje; Zhvillimet ne Cloud; Databaza per E-Qeverisje
3. Shteti dhe qeverisja; Menaxhimi dhe ruajtja e Informacionit; Siguria nga krimet kibernetike; Rregullimi ligjor I databazave; Etika profesionale ne Administrate; Etika profesionale ne E-Qeverisje.

Kandidatët e paraqitur në konkurs:

1. Mag. Mentor Arifaj
Kandidati, Mentor Arifaj, ka të përfunduar studimet 5 vjeçare dhe magjistraturë 2 vjeçare në fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Dega Kompjuterikë me Komunikacion, me notën mesatare 9.51. Ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie si asistent I angazhuar në FIEK dhe në pozita të konsulentit profesional për fushën Teknologjisë Informative. Gjithashtu ka përvojë pune si programer në disa kompani të njohura në Kanada.
Z. Arifaj ka aplikuar në pozitat 1 dhe 2.
2. Msc. Pajtim Rashiti
Kandidati, MSc.Pajtim Rashiti, ka të përfunduar studimet bachelor në kolegjin e Biznesit dhe Teknologjisë – UBT me notë mesatare 7.48, kurse studimet master në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore me notë mesatare 8.0. Ka një përvojë në mësimdhënie në Universitetin "Kadri Zeka", si dhe trajnime të ndryshme. Ka aplikuar për të gjitha pozitat 1 deri 2.
3. MSc. Mergim Hoti
Kandidati Mërgim Hoti ka të përfunduara studimet bachelor në UPZ, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me notë mesatare 8.21, dhe studimet Master me notë mesatare 8.19 në po

të njëjtin Fakultet. Ka një angazhim një semestër në UPZ. Është PhD.Cand në Shkenca Kompjuterike në Universitetin e Evropës Juglindore. Ka aplikuar për pozicion 1 dhe 3.

4. MSc. Shqiprim Haliti

Kandidati Shqiprim Haliti ka të përfunduara studimet bachelor në UP, Fakultetin Juridik me notë mesatare 8.83, si dhe studime të dyta bachelor në UP Fakultetin Filozofik në Shkenca Politike, me notë mesatare 8.84, dhe studimet Master në UP Fakultetin Juridik, pastaj Master në Vilnius University në Lituani si dhe master of Law (LLM) në Ohio në SHBA. Ka angazhim në kolegje private. Ka aplikuar për pozicion 3.

5. Msc. Qëndresa Sejdiu

Kandidatja, MSc.Qëndresa Sejdiu, ka të përfunduar studimet bachelor në UP, Fakultetin Juridik me notë mesatare 9.13, kurse studimet master po në UP, Fak. Juridik me notë mesatare 9.45. Ka qenë e angazhuar për një semestër në UKZ. Ka aplikuar për pozicionin 3.

6. MSc. Dritor Mehmeti

Kandidati Dritor Mehmeti, ka të përfunduar studimet bachelor në UKZ, Fakultetin Ekonomik me notë mesatare 9.77, kurse studimet master po në UKZ, programi E-Qeverisje me notë mesatare 9.73. Ka aplikuar për pozicionin 3.

V L E R Ë S I M

Komisioni në përbërje:


1. Prof.Asoc. Dr. Artan Dermaku - Kryetar
2. Prof.Asoc. Dr. Sadik Haxhiu - anëtar,
3. Prof.Ass. Dr. Xhevat Sopi - anëtar;

duke u bazuar në Rregulloren mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm - me honorar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, pasi shqyrtoi të gjitha aplikacionet e dorëzuara për këtë pozitë, i propozon Këshillit të Fakultetit që kandidatët, si më poshtë:

- Për pozitën nr. 1 sipas konkursit propozohet kandidati **Mag. Mentor Arifaj**. Kandidati në fjalë plotëson kushtet sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm. Ka të përfunduar studimet 5 vjeçare dhe magjistraturë 2 vjeçare në fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Dega Kompjuterikë me Komunikacion, me notën mesatare 9.51. Ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie si asistent I angazhuar në FIEK dhe në pozita të konsulentit profesional për fushën Teknologjisë Informative. Gjithashtu ka përvojë pune si programer në disa kompani të njohura në Kanada.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Mergim Hoti i plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që ka më pak përvojë pune akademike sesa kandidatët tjerë.
- Pajtim Rashiti, është propozuar për një grup tjetër lëndësh



- Për pozitën nr. 2 sipas konkursit, propozohet **Msc.Pajtim Rashiti**. Kandidati, MSc.Pajtim Rashiti, ka një përvojë në mësimdhënie në Universitetin "Kadri Zeka" në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe në Fakultetin e Shkencave Aplikative, si dhe performancë të mirë të shprehur si nga ana e kolegëve ashtu edhe të studentëve. Ka kryer gjithashtu trajnime të ndryshme.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Mentor Arifaj, është propozuar për një grup tjetër lëndësh

- Për pozitën nr. 3 sipas konkursit propozohet **Msc.Shqiprim Haliti**. Kandidati Shqiprim Haliti ka të përfunduara studimet bachelor në UP, në dy Fakultete të ndryshme, në Fakultetin Juridik si dhe atë Filozofik si dhe në Shkenca Politike. Gjithashtu ka disa studime në master në UP Fakultetin Juridik, pastaj Master në Vilnius University në Lituani si dhe master of Law (LLM) në Ohio në SHBA. Ka angazhime në kolegje private.

Kandidatët tjerë të paraqitur për këtë grup lëndësh:

- Mergim Hoti i plotëson kushtet e konkursit sipas rregullores mbi procedurat e angazhimit të stafit të jashtëm, por nuk përzgjedhet, pasi që fusha e studimeve nuk përkon me lëndët e paraqitura në konkurs, e që janë nga fusha juridike, kurse kandidati është nga fusha e Kompjuterikës.
- Qëndresa Sejdiu, i plotëson të gjitha kushtet sipas konkursit, por komisioni është i mendimit, që kandidati i propozuar i plotëson më mirë kushtet, pasi që ka studime të shumëfishta si bachelor ashtu edhe master, ka një përvojë më të madhe dhe është më i përafërt me lëndët në konkurs.
- Dritor Mehmeti, i plotëson kushtet sipas konkursit, por është jo i përafërt me lëndët në konkurs, pasi që kandidati është më shumë nga fusha ekonomike.

Komisioni:

Gjilan, 21.10.2020

1. Prof.Asoc. Dr. Artan Dermaku - Kryetar

2. Prof.Asoc.Dr. Sadik Haxhiu - anëtar

3. Prof.Ass. Dr. Xhevat Sopi - anëtar

